

I.Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik në kategorinë “Asistent Lektor” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit për lëndët si më poshtë:

1. Menaxhim projektsh
2. Biznes Ndërkombëtar
3. Ekonomi dhe Organizim Ndërmarrje

Kriteret e punësimit në vendin vakant për personel akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Menaxhimit Prodhimit, në pozicionin asistent lektor në disiplinat e fushës Menaxhim janë si më poshtë vijon:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare në Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, ose në Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë, Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Administrim Biznesi, me një notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100.
2. Kandidati duhet të ketë një notë mesatare mbi 9.0 në grup-lëndët “Mjedis European i Biznesit”, “Biznes Ndërkombëtar” dhe “Tregje Ndërkombëtare dhe Globalizim”.
3. Kandidati duhet të ketë eksperiencë, së paku prej pesë (5) vitesh, në mësimdhënie.
4. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime apo kanë realizuar publikime shkencore brenda ose jashtë vendit, në fushën e menaxhimit.
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshminë përkatëse.
6. Kandidati duhet të ketë eksperiencë në fushën e menaxhimit të projekteve.
7. Preferohen kandidatët që janë në proces doktorature.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **27.02.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.